



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të Ligjit nr. 03 / L - 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të Instruksionit për rishikimin e buxhetit të vitit 2020, të lëshuar nga Ministria e Financave, dt. 05.06.2020, dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.06.2020, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**RISHIKIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për rishikimin e buxhetit të vitit 2020.

**II.**

Qëllimi, në kuptim të pikës I të këtij vendimi, është që sipas instruksioneve të Ministrisë së Financave për rishikimin e buxhetit të vitit 2020, shuma prej 5,500,000.00 € të orientohet nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë subvencione dhe transfere.

**III.**

Ridestinimi i kategorive të cekura në pikën II të këtij vendimi, do të bëhet sipas shtojcës së bashkëngjitur këtij vendimi.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtorja e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-030/01-0088898/20, më 11.06.2020

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta



## **A r s y e t i m**

Në bazë të instruksionit të Ministrisë së Financave për rishikimin e buxhetit për vitin 2020, të dt. 05.06.2020, për të siguruar stabilitetin financiar dhe sigurimin e mjeteve për zbatimin e masave të pakos emergjente fiskale për arsye të pasojave të COVID-19, Komuna e Prishtinës ka bërë rishikimin e buxhetit të vitit 2020.

- I. Gjithsej buxheti i propozuar për riorientim është 5,500,000.00 €. Këto mjete janë marrë nga kategoria e investimeve kapitale dhe orientohen në subvencione dhe transfere, gjegjësisht për pakon ekonomike “Prishtina 2”.